



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.58, datë 25.04.2024

PËR

**“VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS TË ZONJËS BRISIDA LEKA,
KANDIDATE PËR MAGJISTRAT PROKURORE, E CILA DO TË DIPLOMOHET
NGA SHKOLLA E MAGJISTRATURËS NË VITIN 2024”**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 159 dhe 189 pika 1, të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 32 dhe 35 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin, emërimin si magistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve” e ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale “Për verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatës për magistrat prokurorë zonjës Brisida Leka, e cila mund të diplomohet nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2024”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Relacionit të kandidatës për t’u emëruar prokurorë, zonjës Brisida Leka, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të vlerësojë të përfunduar verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatës Brisida Leka.
3. Lejimin e kandidatës Brisida Leka të vijojë me procedurat e mëtejshme për emërimin e saj si prokurorë.
4. Të njoftohet për këtë vendim zonja Brisida Leka.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më datë 25.04.2024.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Alfred Balla

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Zeqir Hoxha

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Vate Staka

